



REPUBLIKA E SHQIPERISË

BASHKIA PEQIN

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Peqin, më \_\_\_\_/\_\_\_\_/2023

PROJEKT-VENDIM

Nr. \_\_\_, Datë \_\_\_. \_\_\_. 2023

**“PËR MIRATIMIN E KËRKESËS PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË PEQIN, TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE QË DO TË PËRDOREN PËR USHTRIMIN E DETYRAVE TË SAJ FUNKSIONALE NË FUSHËN ADMINISTRATIVE”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b” dhe nënpika 1.2, shkronja “a”, nenit 23, pika 14, nenit 54, shkronja “k”, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, nenit 3, të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 500, datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” të ndryshuar, Udhëzimit nr.15, datë 30.06.2003, “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike”, Kryetari i Bashkisë i propozon Këshillit të Bashkisë Peqin,

**PROPOZIM :**

1. Miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi të Bashkisë Peqin të pronave të paluajtshme shtetërore që do të përdoren për ushtrimin e detyrave të saj funksionale në fushën administrative, sipas formularëve 1 dhe 2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij projekt-vendimi.
2. Ngarkohen Kryetari i Bashkisë, Drejtorja e Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit, dhe Drejtorja Juridike, Burimeve Njerëzore dhe TIK për zbatimin e këtij projekt-vendimi.
3. Ky projekt-vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut, Elbasan.

Konceptoi

G.Cani

KRYETARI I BASHKISË

Bukurish MACI

